

Shtojca 19:

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE
KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomike)

Evia20 shpk

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

M 03025401 O

Nuis/Nipt

Rruga Fier-Zharres, km 10

Adresa

Fier

Albania

Qyteti

Shteti

Kodi Postar / Posta

+35569 399 6007

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

evia20shpk@gmail.com

E-mail

Administrator Endrit Doko

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2023/05/12

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

+35569 399 6007

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)



Seksioni II. Informacion mbi procedurën

1. Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.
REF-68226-05-04-2023

2. Lloji i Procedurës

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur për prokurimin në fjalë.

Procedurë e hapur

Procedurë e hapur e thjeshtuar

Procedurë e kufizuar

Procedurë konkurruese me negociim

Partneritet për inovacion

Dialog konkurrues

Procedurë me negociim me shpalljeprapaketënjoftimit

Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës

Shërbim Konsulence

Kontratë e lidhur pa zhvilluar ndonjë nga procedurat e prokurimit të parashikuara në LPP

3. Autoriteti /Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.
"Eco- Elb" sh.a.

4. Vlera e përllogaritur e prokurimit

(Vlera e përllogaritur e kontratës/marrëveshjes kuadër) (shuma në shifra dhe fjalë)
2.405.800 (dymilion e katerqind e pesemije e teteqind) leke pa TVSH

5. Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

(Përshkrimi i shkurtër i punëve / mallrave / shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër)



Blerje materiale elektrike

6. Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

(Data (viti/muaji/dita)

2023/05/19

7. Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

8. **Data e nënshkrimit të kontratës**

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

Seksioni III. Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore (Shkelje ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Hartimi i dokumentave të tenderit është bërë në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik dhe Rregullat e Prokurimit Publik

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkon pavlefshmërinë)



- Tjetër



(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet

Njësia e hartimit të dokumentave të tenderit ka vendosur kritere kualifikimi të kundraligjshme dhe specifikime teknike të cilat kufizojnë konkurrencen e lirë dhe paracaktojnë fituesin e kësaj procedure

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkelejt e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit kontraktor.

Pasi u njohëm me DT të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje materiale elektrike” konstatuam disa mangësi në hartimin e dokumentave të tenderit. Bazuar në nenin 110 të LPP nr. 162/2020 datë 23.12.2020 dhe nenin 97 të V.K.M. nr. 285 datë 19.05.2021 Për RrPPP i ndryshuar po paraqesim këtë formular ankese duke kërkuar modifikimin e kritereve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike të dokumentave të tenderit. Në piken 2.3.2 të kriteret teknike të kualifikimit është kërkuar:

“Operatori ekonomik duhet të paraqesi një dëshmi nga administrata tatimore për punesimin mesatar jo më pak se 5 punonjës për të pakten muajin e fundit shoqëruar me Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe vertetimim për pagesën e kontributeve. Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.”

Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 neni 40 “Kontratat e Mallrave” pika 3 përcaktohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve”. Nisur nga sa më lart, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.



Bazuar në objektin e prokurimit të kësaj procedure prokurimi, si dhe volumit të kontratës, gjykojme, se kërkesa për këtë kriter është e ekzagjeruar dhe jo në përpjesëtim të drejtë me volumin e kontratës, objektin e prokurimit, duke vlerësuar se nuk është e nevojshme kërkesa për paraqitjen e jo më pak se 5 (pese) persona të punësuar të siguruar. Në një kontratë ku kërkohet **vetem furnizimi** me mallin objekt prokurimi dhe jo furnizim vendosje (ku ndoshta ky kriter mund të ishte i justifikueshem) kjo kërkesë është në kundërshtim me rregullat e prokurimit public. Për më tepër AK nuk kërkon ndonjë specialist fushë në këtë procedure, pasi do të ishte e ekzagjeruar kur nuk kemi të bëjmë me mallra të ndonjë specifike të veçante e do të duhej asistencë teknike e specializuar. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik

Për sa më sipër kërkojmë nga ju heqjen e këtij kriteri diskriminues.

Në pikën 2.3.7 të kriterit teknik të kualifikimit është kërkuar:

“ Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur edhe me certifikatat e mëposhtme të lidhura me objektin

që kërkohet të prokurimet:

...

Sistemi menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë ISO 45001 (e vlefshme) Qëllimi i certifikimit

të operatorit ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë në fushën e objektit që prokurimet.

PAS 99-2012 sistemi i menaxhimit të integruar

Certifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë...”

Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 nëni 40 “Kontratat e Mallrave” pika 3 përcaktohet se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”. Nisur nga sa më lart, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

ISO 45001 është standardi ndërkombëtar i cili përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurisë në punë.



Kërkesat e standardit ISO 45001 përfshijnë: vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve. Ky certifikim konfirmon angazhimin e shoqërisë për të marrë masat e nevojshme për të mbrojtur punonjësit e saj dhe të çdo personi tjetër **në ambientet e saj**. Nisur nga kjo AK nuk ka pse ti interesoj ky certifikim për realizimin apo jo me sukses të kontratës së furnizimit. Nuk është një kontratë pune apo shërbimi i cili do të merret në ambientet e OE. Kjo është një përgjegjësi e OE që nuk përben kusht për realizimin në kohe apo me sukses të kontratës së furnizimit. Ky kriter është në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik dhe nuk është i justifikuar prandaj kerkojme heqjen e tij.

Për sa i përket Certifikimi i PAS 99 konfirmon faktin që shoqëria ka një qasje të saktë ndaj zhvillimit dhe zbatimit të sistemit të saj të menaxhimit të integruar, certifikim i cili nuk lidhje me objektin e prokurimit, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se do të jenë të suksesshem në realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Ky kriter është në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik dhe nuk është i justifikuar prandaj kerkojme heqjen e tij.

5. Kërkesë për ekspertizë të posacme

Po

Jo

x

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

JO

7. Lista e informacionit konfidencial:

JO



Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes :Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit /Enti Kontraktor dhe Komisionit te Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail: evia20shpk@gmail.com

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/ Përfaqësuesi i autorizuar

Endrit Doko

